

GJYKATA KOMINALE NË PRISHTINË

P Nr. 63/04

Data: 30 korrik 2009

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Komonale në Prishtinë, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët e EULEX - it, Arkadiusz SEDEK, kryetari i trupit gjykues, dhe Gerrit Mark SPRENGER, dhe, gjyqtari vendor, Agim MALIQI, si anëtarë, me ndihmën e procesmbajtëses Valentina GASHI, në çështjen penale kundër:

Sllavko STALETIVIÇ, i bir i Stales dhe Dobrillës (emri i vajzërisë, Gjorgjeviq), i lindur më 28.08.1956, në Bitinën e Poshtme, i martuar, baba i dy fëmijëve, kombësia serbe, i akuzuar për veprë penale të Nxitjes Nacionale, Racore, Religjioze, dhe Urrejtjes Etnike, Grindjes ose Jo Tolerancës, në pajtim me nenin 115, paragrafi 1, i KPK - së.

Pas mbajtjes së dëgjimit kryesor para publikut, më 08, 15 dhe 30 korrik 2009, me praninë e të akuzuarit të lartpërmendur, dhe të Prokurorit Publik të EULEX - it, Paul Scoggin;

pas këshillimit të Trupit Gjykues, mbajtur më 30 korrik 2009, dhe duke u bazuar në nenin 391 (1), të KPPK - së;

e shpallur para publikut dhe në praninë e të akuzuarit dhe të Prokurorit Publik, si vijon:

AKTGJYKIM

1) I akuzuari Sllavko STALETIVIÇ, me të dhënat e përmendura më lart,

shpallet fajtor

Për veprë penale të Nxitjes Nacionale, Racore, Religjioze, dhe Urrejtjes Etnike, Grindjes ose Jo Tolerancës, në pajtim me nenin 115, paragrafi 1, i KPK - së.

Për arsye se i akuzuari është shpallur fajtor për veprat penale sikurse është akuzuar në aktakuzë ngritur nga Prokurori Publik, veçanërisht:

Më 02 shtator 2004, aty rreth orës 10:15, para hyrjes së shkollës fillore “Anton Santori”, e cila gjendet në mes të Bitit të Poshtëm dhe Bitit të Epërm, i akuzuari në vend publik ka nxitur publikisht urrejtje, grindje ose jo tolerancë në mes të grupeve nacionale, racore, religjioze, etnike ose grupe të tilla të tjera, të cilat jetojnë në Komunën e Shtërpcës, duke i thënë palës së dëmtuar, Z. Ali HALIMI, në gjuhën serbishte “Ta q.... nënën e shqiptarit, do ta këpus kokën”, i cili ishte në cilësinë e Zyrtarit për Kthim të Komuniteteve, në Komunën e Shtërpcës, deri sa Z. HALIMI, regjistronte me kamerë digjitale, fëmijët dhe prindërit shqiptarë, të cilët po ktheheshin në shkollë me qëllim të vazhdimit të procesit arsimor. I akuzuari ka përdorur fjalë urrejtjeje sikurse: “ne asgjë nuk ju kemi bërë gjatë luftës 1998 - 1999, çka kemi me ju bo në luftën që do të vije, ne duhet të ju premë në fyt, duke i përfshirë dhe fëmijët, e ju duhet të i dërgoni ata tek kasapi të i thërnin ata, e jo në shkollë. Kjo është Serbi, dhe jo Kosovë”, e pastaj ai u mundua që të rrëmbej kamerën, por një oficer i policisë amerikane ndërhyri dhe tërhoqi të akuzuarin anash nga vendi i ngjarjes.

VENDIMI

Sllavko STALETUVIÇ

Në pajtim me nenin 3, paragrafi 1 (1 dhe 3), nenin 6, nenin 11, paragrafi 1, nenin 15, paragrafët 1 dhe 2, nenet 34 dhe 38, paragrafët 1 dhe 2, është dënuar me burg, prej 120 ditësh.

Në pajtim me nenin 41, paragrafi 1 (1), nenin 42, nenin 43, paragrafi 2, neni 44, paragrafët 1, 2 dhe 3, dënimi nuk do të ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale, gjatë periudhës kohore tri vjeçare, pasi vendimi të bëhet final.

Në pajtim me nenin 54, paragrafët 1 dhe 2 (1) dhe nenin 39, paragrafët 1, 3, 4 dhe 5, neni 64, paragrafët 1 dhe 3, i vihet gjoba me shumë prej 200 eurosh, brenda 10 muajsh që pagesa të bëhet me këste mujore, nga 20 euro.

KËRKESË PRONËSIE

Nuk ka kërkesë pronësie.

SHPENZIMET

Në pajtim me nenin 99 dhe nenin 102, të KPPK - së, i pandehuri është i obliguar që të e bëjë kompensimin e shpenzimeve të përgjithshme të procedurës, të cilat janë përcaktuar, me shumën prej 100 eurosh.

Kryetari i Trupit Gjykses
Arkadiusz SEDEK

Këshilla Ligjore:

Në pajtim me nenin 400 (1), të KPPK - ë, ankesa duhet të bëhet brenda 8 ditësh, që na shpallja e këtij vendimi, dhe në pajtim me nenin 398 (1) të KPPK – së, ankesa do të mbahet në këtë gjykatë, brenda 15 ditësh nga data që kopja e vendimit ju është dorëzuar palëve.